



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1542 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 35 Datë 20.07.2026

PËR

SHFUQIZIM VENDIMI Nr. 2, DATË 26.01.2026 PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79, DATË 20.12.2024 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të Ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe bazuar ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Aneksi 9 "Granti I Performancës për bashkitë", Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrit të shtetit për Pushtetin Vendor nr. 10315 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025, Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë 2025, shkresës së Ministrisë së Financave- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, datë 24.12.2025, Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 20.07.2026 me propozim të Kryetarit,

VENDOSI:

I.Të shfuqizojë vendimin për shtesën në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të vitit 2025, si më poshtë:

➤ SHTOHEN TË ARDHUKAT:

Gr.00,Kap.01,Tit. 04960, Art. 604 Transferta e pakushtëzuar e sektoriale, në vlerën **2,813,957,43** lekë

➤ SHTOHEN SHPENZIMET:

● Gr. 00, Kap. 01, Tit. 04520, Artik. 231, , në vlerën **2,813,957,43** lekë

● **Totali i shpenzimeve është në vlerën 2,813,957,43 lekë**

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit inanciar, pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore", pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratur me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1520 prot

Libohovë më 14.07.2026

PROJEKT/VENDIM

Nr. Datë __.07.2026

PËR

SHFUQIZIM VENDIMI Nr. 2, DATË 26.01.2026 PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79, DATË 20.12.2024 TË KËSHILLIT TË BASHKISË LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2025"

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të Ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe bazuar ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Aneksi 9 "Granti I Performancës për bashkitë", Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrit të shtetit për Pushtetin Vendor nr. 10315 dhe nr. 10725, datë 11.07.2025, Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të aplikimeve në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë 2025, shkresës së Ministrisë së Financave- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, datë 24.12.2025 , Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës __.07.2026 me propozim të Kryetarit,

VENDOSI:

I. Të miratojë shtesën në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të vitit 2025, si më poshtë:

➤ **SHTOHEN TË ARDHURAT:**

Gr.00,Kap.01,Tit. 04960, Art. 604 Transferta e pakushtëzuar e sektoriale, në vlerën **2,813,957,43** lekë

➤ **SHTOHEN SHPENZIMET:**

● Gr. 00, Kap. 01, Tit. 04520, Artik. 231, , në vlerën **2,813,957,43** lekë

- **Totali I shpenzimeve është në vlerën 2,813,957,43 lekë**



II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit inanciar ,pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore", pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

JURISTI

Kristaq Ciko

PËRGJEGJËS SEK.FINANCIAR

Joana Memo





REPUBLIKA E SHQIPËRI SË
BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
RELACION

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LIDHUR
ME SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCE**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe në zbatim të shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 4018, datë 04.03.2026, për shpërndarjen e grantit të bazuar në performancë, paraqitet për shqyrtim dhe miratim shfuqizimi i vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak.

Granti i bazuar në performancë, sipas shkresës së dërguar pranë Bashkisë Libohovë, është akorduar në vlerën totale **2,813,957.43 lekë**, me këtë strukturë financimi:

- Grant me burim financimi të brendshëm: **1,258,426.97 lekë**;
- Grant me burim financimi të huaj: **1,555,530.46 lekë**.

Gjatë përgatitjes së materialit, në projektvendim burimet e financimit janë pasqyruar të ndara, sipas grantit të brendshëm dhe atij të huaj, në përputhje me shkresën e Ministrisë së Financave. Megjithatë, në vendimin e miratuar nga Këshilli Bashkiak, shuma është pasqyruar në total, pa u bërë ndarja sipas burimeve të financimit, duke përfshirë edhe grantin me burim të brendshëm si shtesë buxheti. Ky pasqyrim nuk është në përputhje me mënyrën e financimit të grantit dhe ka sjellë pasaktësi në zbatimin e vendimit.

Granti me burim financimi të brendshëm në vlerën **1,258,426.97 lekë** është pasqyruar tashmë në buxhetin e Bashkisë nëpërmjet të ardhurave të trashëguara, ndërsa objekt i shtesës së buxhetit duhet të jetë vetëm granti me burim financimi të huaj në vlerën **1,555,530.46 lekë**.

Për shkak të këtij pasaktësimi, Dega e Thesarit nuk mund të ekzekutojë vendimin, pasi në llogarinë përkatëse nuk ndodhet gjendja financiare në shumën **2,813,957.43 lekë**, e cila është miratuar në vendim. Për rrjedhojë, vendimi është i pazbatueshëm dhe kërkon korrigjim.


Për sa më sipër, me qëllim që aktet buxhetore të jenë në përputhje me gjendjen reale të fondeve dhe burimet e tyre të financimit, propozohet shfuqizimi i vendimit ekzistues.

Pas shfuqizimit të tij, do të paraqitet për miratim një projektvendim i ri, i cili do të parashikojë vetëm shtesën e grantit me burim financimi të huaj në vlerën

1,555,530.46 lekë, ndërsa granti me burim financimi të brendshëm nuk do të jetë objekt i këtij vendimi, pasi është reflektuar tashmë në buxhet nëpërmjet të ardhurave të trashëguara.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak i Libohovës të miratojë projektvendimin për **shfuqizimin e vendimit në fuqi**, me qëllim korrigjimin e pasaktësive të konstatuara dhe miratimin e një vendimi të ri, në përputhje me burimet reale të financimit dhe legjislacionin në fuqi.

Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly "M. M. M.", written over a horizontal line.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1543 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 36 Datë 20.07.2026

MBI

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË
LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN
2026



Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Këshilli i Bashkisë Libohovë si dhe udhëzimit Nr.20 i datës 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, tregusit për ndarjen e fondit, tër grandit bazuar në performancës për vitin 2025", në mbledhjen e datës 20.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtesë në Buxhetin e vitit 2026.

VENDOSI:

I. Të miratojë Shtesën e të ardhurave në buxhetin e bashkisë për 2026:

➤ SHTOHET TË ARDHURAT:

Nga Grandi i Bazuar në Performancë, grandit i huaj Gr.00, Kap. 02, kod projekti 90005AF, llogaria ekonomike 1061099 me vlerë 1,555,530.46 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e dyzetë e gjashtë qindarka)

➤ SHTOHEN SHPENZIMET:

Gr.00, Kap. 02, Tit. 06260, Artik. 231 vlerë 1,555,530.46 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e dyzetë e gjashtë qindarka), "Blerje Autobetoniere për nevojat e Bashkisë"

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 53 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore", pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi




KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



Miratuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË**

PROJEKT VENDIM

Nr. 1519 Prot

Libohovë, më 14.07.2026

Nr. _____, Datë _____ . _____ .2026

MBI

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË
BASHKISË LIBOHOVË “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISË
LIBOHOVË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor“, Këshilli i Bashkisë Libohovë si dhe udhëzimit Nr.20 i datës 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, tregusit për ndarjen e fondit, tër grandit bazuar në performancës për vitin 2025”, në mbledhjen e datës _____ . _____ .2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtesë në Buxhetin e vitit 2026.

VENDOSI:

Të miratojë ndryshim në buxhetin e bashkisë për 2026:

➤ SHTOHET TË ARDHURAT:

Nga Grandi i Bazuar në Performancë, grandit i huaj Gr.00, Kap. 02, kod projekti 90005AF , llogaria ekonomike 1061099 me vlerë 1,555,530.46 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e dyzetë e gjashtë qindarka)

➤ SHTOHEN SHPENZIMET :

Gr.00, Kap. 02, Tit. 06260, Artik. 231 vlerë 1,555,530.46 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e dyzetë e gjashtë qindarka), “Blerje Autobetoniere për nevojat e Bashkisë”

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

2. Ky vendim u shpall sot më datë _____.2026 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

JURIST

Kristaq Ciko



SHEF.SEK FINANICAR

Joana Memo





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË**

**SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
RELACION**

Të nderuar këshilltar!

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS NË TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E
BUXHETIT TË VITIT 2026 NGA GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË ME
BURIM FINANCIMI TË HUAJ**

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe të vetëqeverisjes vendore, paraqesim për miratim shtesën në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të vitit 2026.

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 4018 prot., datë 04.03.2026, Bashkia është njoftuar për përfitimin e Grantit të Bazuar në Performancë me burim financimi të huaj, në kuadër të programit të mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore. Në programin e investimeve të Bashkisë, në fondet e trashëguara, është planifikuar realizimi i investimit për blerjen e një autobetonierie me vetëshkarkim, e cila do të përdoret për përmbushjen e nevojave të Bashkisë në kryerjen e punimeve dhe shërbimeve publike në territor.

Për të siguruar realizimin e këtij investimi dhe duke qenë se destinacioni i përdorimit të Grantit të Bazuar në Performancë është në përputhje me objektivat e zhvillimit dhe përmirësimit të kapaciteteve të bashkisë, propozohet që një pjesë e financimit të autobetonieries, në vlerën 1,555,530.46 lekë, të mbulohet nga fondet e Grantit të Bazuar në Performancë me burim financimi të huaj, ndërsa pjesa tjetër të financohet nga fondet e planifikuara në buxhetin e bashkisë.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të vitit 2026 në shumën 1,555,530.46 lekë, me burim financimi nga Granti i Bazuar në Performancë me financim të huaj, për financimin e pjesshëm të blerjes së autobetonieries me vetëshkarkim.

Për këto arsye, propozohet miratimi i projektvendimit përkatës nga Këshilli Bashkiak.

Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

Joana Memo

Nr 525 Prot
H. 18.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 4018 prot.

Tiranë, më 4.3.2026

Lënda: Shpërndarja e grantit të bazuar në performancë me burim financimin e huaj

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

BASHKISË Libohovë

Në zbatim të Udhëzimit të përbashkët midis Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për ndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë në vitin 2025" dhe pikës 143 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2026", dërgojmë transfertën e grantit të bazuar në performancë me burim financimin e huaj, disbursuar gjatë vitit 2025 nga donatori në TSA, sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri



30. 11. 2017

Ent. Qev.	M
152	

Ent. Qev.	Min.Linj	Kodi Inst.	Emër Inst.	Kap	Llogaria Ekonomike	Kod projekti	Kodi / Thesart	TOTAL
SHITESË								
152	00	2152001	Bashkia Belsh	00	1061099	90005AF	0808	2,666,624
102	00	2102001	Bashkia Berat	00	1061099	90005AF	0202	3,333,280
103	00	2103001	Bashkia Bulqizë	00	1061099	90005AF	0603	4,999,919
110	00	2110001	Bashkia Cërrik	00	1061099	90005AF	0808	5,444,357
104	00	2104001	Bashkia Delvine	00	1061099	90005AF	3704	4,888,810
105	00	2105001	Bashkia Devoll	00	1061099	90005AF	1505	1,666,640
106	00	2106001	Bashkia Dibër	00	1061099	90005AF	0606	6,111,013
147	00	2147001	Bashkia Divjakë	00	1061099	90005AF	0922	4,333,263
452	00	2452001	Bashkia Dropull	00	1061099	90005AF	1111	6,555,450
107	00	2107001	Bashkia Durrës	00	1061099	90005AF	0707	2,777,733
109	00	2109001	Bashkia Elbasan	00	1061099	90005AF	0808	7,777,652
111	00	2111001	Bashkia Fier	00	1061099	90005AF	0909	1,555,530
326	00	2326001	Bashkia Finiq	00	1061099	90005AF	3704	1,666,640
155	00	2155001	Bashkia F-Arrez	00	1061099	90005AF	3330	6,555,450
115	00	2115001	Bashkia Gjirokastrë	00	1061099	90005AF	1111	555,547
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	00	1061099	90005AF	0810	6,111,013
117	00	2117001	Bashkia Has	00	1061099	90005AF	1812	5,999,903
160	00	2160001	Bashkia Himarë	00	1061099	90005AF	3737	6,111,013
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	00	1061099	90005AF	3535	5,555,466
118	00	2118001	Bashkia Kavajë	00	1061099	90005AF	3513	555,547
154	00	2154001	Bashkia Këlcyrë	00	1061099	90005AF	1128	1,555,530
654	00	2654001	Bashkia Klos	00	1061099	90005AF	0625	3,888,826
120	00	2120001	Bashkia Kolonjë	00	1061099	90005AF	1514	8,777,636
156	00	2156001	Bashkia Konispol	00	1061099	90005AF	3731	6,111,013
122	00	2122001	Bashkia Korçë	00	1061099	90005AF	1515	1,111,093
123	00	2123001	Bashkia Krujë	00	1061099	90005AF	0716	555,547
124	00	2124001	Bashkia Kuçovë	00	1061099	90005AF	0217	1,555,530
125	00	2125001	Bashkia Kukës	00	1061099	90005AF	1818	4,333,263
126	00	2126001	Bashkia Kurbin	00	1061099	90005AF	2019	3,222,170
127	00	2127001	Bashkia Lezhë	00	1061099	90005AF	2020	3,222,170
116	00	2116001	Bashkia Libohovë	00	1061099	90005AF	1111	1,555,530
128	00	2128001	Bashkia Librazhdë	00	1061099	90005AF	0821	8,888,746
129	00	2129001	Bashkia Lushnjë	00	1061099	90005AF	0922	3,777,717
130	00	2130001	Bashkia Malësi e M	00	1061099	90005AF	3323	6,111,013
168	00	2168001	Bashkia Maliq	00	1061099	90005AF	1515	5,555,466
131	00	2131001	Bashkia Mallakastrë	00	1061099	90005AF	0924	1,555,530
132	00	2132001	Bashkia Mat	00	1061099	90005AF	0625	8,888,746
143	00	2143001	Bashkia Memaliaj	00	1061099	90005AF	1134	1,555,530
133	00	2133001	Bashkia Mirditë	00	1061099	90005AF	2026	1,666,640
112	00	2112001	Bashkia Patos	00	1061099	90005AF	0909	4,888,810
134	00	2134001	Bashkia Peqin	00	1061099	90005AF	0827	4,333,263
135	00	2135001	Bashkia Përmet	00	1061099	90005AF	1128	3,777,717
136	00	2136001	Bashkia Pogradec	00	1061099	90005AF	1529	5,444,357
140	00	2140001	Bashkia Polican	00	1061099	90005AF	0232	3,777,717
153	00	2153001	Bashkia Prenjas	00	1061099	90005AF	0821	7,777,652
137	00	2137001	Bashkia Pukë	00	1061099	90005AF	3330	7,666,543
499	00	2499001	Bashkia Pustec	00	1061099	90005AF	1515	3,222,170
113	00	2113001	Bashkia Roskovec	00	1061099	90005AF	0909	3,222,170
119	00	2119001	Bashkia Rrogozhinë	00	1061099	90005AF	3513	1,566,640
138	00	2138001	Bashkia Sarandë	00	1061099	90005AF	3731	3,888,826
159	00	2159001	Bashkia Selenicë	00	1061099	90005AF	3737	2,777,733
108	00	2108001	Bashkia Shijak	00	1061099	90005AF	0707	6,111,013
141	00	2141001	Bashkia Shkodër	00	1061099	90005AF	3333	1,555,530
139	00	2139001	Bashkia Skrapar	00	1061099	90005AF	0232	1,555,530
142	00	2142001	Bashkia Tepelenë	00	1061099	90005AF	1134	6,666,559
101	00	2101001	Bashkia Tiranë	00	1061099	90005AF	3535	555,547
145	00	2145001	Bashkia Tropojë	00	1061099	90005AF	1836	6,111,013
167	00	2157001	Bashkia Dimal	00	1061099	90005AF	0202	4,333,263
157	00	2157001	Bashkia V.Dejës	00	1061099	90005AF	3333	4,333,263
146	00	2145001	Bashkia Vlorë	00	1061099	90005AF	3737	555,547
165	00	2165001	Bashkia Vorë	00	1061099	90005AF	3535	3,888,826
TOTAL								247,218,234

**Vendimi përfundimtar mbi shpërndarjen e fondit sipas bashkive dhe burimit të financimit
në kuadër të GBP 2025**

Bashkia		GBP 2025				Burimi	
		Pesha në %	Shuma Fikse	Shuma Shtesë	Total	I brendshëm	I huaj
Nr.	Total	0.36	163,124,683.82	284,093,550.48	447,218,234.30	200,000,000.00	247,218,234.30
1	Belsh	0.24	1,759,547.15	3,064,379.87	4,823,927.02	2,157,303.37	2,666,623.65
2	Berat	0.30	2,199,433.94	3,830,474.84	6,029,908.78	2,696,629.21	3,333,279.56
3	Bulqizë	0.45	3,299,150.91	5,745,712.26	9,044,863.17	4,044,943.82	4,999,919.35
4	Cërrik	0.49	3,592,408.77	6,256,442.24	9,848,851.00	4,404,494.38	5,444,356.62
5	Delvinë	0.44	3,225,836.44	5,618,029.76	8,843,866.21	3,955,056.18	4,888,810.03
6	Devoll	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
7	Dibër	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
8	Dimal	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
9	Divjakë	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
10	Dropull	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
11	Durrës	0.25	1,832,861.62	3,192,062.36	5,024,923.98	2,247,191.01	2,777,732.97
12	Elbasan	0.70	5,132,012.52	8,937,774.62	14,069,787.15	6,292,134.83	7,777,652.32
13	Fier	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
14	Finiq	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
15	Fushë-Arrëz	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
16	Gjirokastrë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
17	Gramsh	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
18	Has	0.54	3,958,981.09	6,894,854.71	10,853,835.80	4,853,932.58	5,999,903.21
19	Himarë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
20	Kamëz	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
21	Kavajë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
22	Këlcyrë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
23	Klos	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16
24	Kolonjë	0.79	5,791,842.71	10,086,917.07	15,878,759.78	7,101,123.60	8,777,636.18
25	Konispol	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
26	Korçë	0.10	733,144.65	1,276,824.95	2,009,969.59	898,876.40	1,111,093.19
27	Krujë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
28	Kuçovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
29	Kukës	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
30	Kurbin	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
31	Lezhë	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
32	Libohovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
33	Librazhd	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50
34	Lushnjë	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
35	Malësi e Madhe	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
36	Maliq	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
37	Mallakastër	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
38	Mat	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. 1574 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 37 Datë 20.07.2026

MBI

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË
LIBOHOVË "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN
2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Këshilli i Bashkisë Libohovë si dhe Aktit Normativ nr 02 datë 30.06.2026 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 87/2025 për buxhetin e vitit 2026", në mbledhjen e datës 20.07 .2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtes në Buxhetin e vitit 2026.

VENDOSI:

I.Të miratojë Shtesën e të ardhurave në buxhetin e bashkisë për 2026:

➤ **SHTOHET TË ARDHURAT:**

Transferta Specifike

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, në vlerën 1,095,000 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë lekë)

➤ **SHTOHET SHPENZIMET :**

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, Artik. 600 zëri "Paga "në vlerën 795,000 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë lekë)

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, Artik. Zëri 601" Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore " në vlerën 300,000 (treqind mijë lekë)

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore", pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË**

PROJEKT VENDIM

Nr. 1526 Prot

Libohovë, më 15.04.2026

Nr. _____, Datë _____ . _____ .2026

MBI

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 70 DATE 24.12.2025 TË KËSHILLIT TË
BASHKISË LIBOHOVË “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISË
LIBOHOVË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Këshilli i Bashkisë Libohovë si dhe Aktit Normativ nr 02 datë 30.06.2026” Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 87/2025 për buxhetin e vitit 2026”, në mbledhjen e datës _____ . _____ .2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Për një shtes në Buxhetin e vitit 2026.

VENDOSI:

Të miratojë Shtesën e të ardhurave në buxhetin e bashkisë për 2026:

➤ **SHTOHET TË ARDHURAT:**


Transferta Specifike

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, në vlerën 1,095,000 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë lekë)

➤ **SHTOHET SHPENZIMET :**

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, Artik. 600 zëri “Paga “në vlerën 795,000 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë lekë)

Gr.00, Kap. 01, Tit. 3280, Artik. Zëri 601” Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore “ në vlerën 300,000 (treqind mijë lekë)



1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar pranë Bashkisë Libohovë.

2. Ky vendim u shpall sot më datë _____.2026 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

JURIST

Kristaq Ciko

SHEF.SEK FINANICAR

Joana Memo





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË**

**SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
RELACION**

Miratimin e shtesës në buxhet nga transferta sektoriale për financimin e rritjes së nivelit të pagave në shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) Në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 'Për buxhetin e vitit 2026'", Bashkisë Libohovë i është akorduar një fond shtesë në vlerën 1,095,000 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë nga transferta sektoriale, Programi 03280, me destinacion mbulimin e efekteve financiare që rrjedhin nga rritja e nivelit të pagave në shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Për këtë arsye, propozohet miratimi i shtesës në buxhetin e vitit 2026, duke: shtuar të ardhurat nga transferta sektoriale në shumën 1,095,000 lekë; shtuar shpenzimet në Programin 03280 – Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi, në artikujt ekonomikë 600 – Paga dhe 601 – Sigurime shoqërore, sipas nevojës për përballimin e efekteve të rritjes së pagave.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i projektvendimit nga Këshilli Bashkiak.

Me konsideratë të lartë!

Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

Joana Memo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1545 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 38 Datë 20.07.2026

PËR

MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR NËNPUNËSIT CIVIL DHE PUNONJËSIT E
BASHKISË PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore Kreu IX, pika 1 të nenit 55, nenit 54 pika ç dhe dh, pika 2 e nenit 55, të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 „Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve , të ligjit nr.152/2013 „Për nënpunësit Civil „ të ndryshuar ,të VKM nr.108 datë 26.02.2014“për planin Vjetor të pranimit në shërbimin Civil,

Në mbështetje të VKM nr.113 ,datë 01.03.2023 për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi , të vendimin nr.502 , datë 01.08.2024 të ndryshuar me vendimin nr .103 ,datë 11.02.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (sipas lidhjet nr 6), të Vendimin nr.548, datë 27.07.2016 për miratimin e kriterëve rregullave dhe procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjesve të shtetit, të VKM nr .127 datë 27.02.2026,“Për disa ndryshime në vendimin nr.425 datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave ,Për trajtimin me pagë dhe shtesa ,mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar të ndryshuar , , të Vendimin nr.104, datë 11.02.2026 , Për një ndryshim në Vendimin nr.419 ,date 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave , “ Për trajtim me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit” ,të Vendimit nr.130 , datë 27.02.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa te vendimit nr.325,date 31.05.2023 Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, Këshilli me propozim të kryetarit të Bashkisë :

VENDOSI:

I.Të miratohet niveli i pagave për nëpunësit civilë dhe punonjësit e bashkisë për vitin 2026”, Për Bashki me numër banorësh nga 5.000 deri në 20.000 (lidhja nr.6) si më poshtë:

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore", pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

Miratuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

	POZICIONI	Kategoria	Shtesa per pozicion
1	Kryetari i BASHKISË	1/ç	246,000
1.1	Kabineti i kryetarit		
	Nënkryetar	1/ç	189,625
	Këshilltar i kryetarit	III-2	109,000
1.2	Spektori për koordinimin e integritimit Europian dhe Ndhmës së Huaj		
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
1.3	Spektori Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit		
	Inspektori i mbrojtjes së territorit	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Inspektori i policisë bashkiake	Pika 10	50,000
2	Spektori i zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar		
	Shef Spektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Magaziner	Pika 11	50,000
3	Spektori i Tatim - Taksave		
	Shef sektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000
	Nëpunës i vjeljes së taksave	Pika 11	50,000
4	Spektori i shërbimeve bujqësore veterinare mjedisore		
	Specialist i bujqësisë	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i pyje kullota menaxhim	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i pyje kullota inspektim	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Mirëmbajtës pyje kullota (kontroll)	Pika 10	50,000
5	Spektori i shërbimit urban		
	Shef Spektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000



	Specialist topograf	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist Inxhinier ndërtimi/mjedis trajtim ujërash	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
5.1	Sektori i shërbimeve publike		
	Mbikqyrës i shërbimeve publike	Pika10	50,000
	Muratorë	Pika 10	50,000
	Muratorë i rrugëve rurale	Pika10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i parqe lulishte ,dekor,pastrim rrugësh,mbetje urbane	Pika10	50,000
	Shofer makinerish	Pika 10	50,000
	Elektriçist	Pika 10	50,000
	Shofer administrate	Pika 11	50,000
	Mirëmbajtës godine (zyra)	Pika10	50,000
6	Sektori i kulturës , arsimit dhe mirëqënies sociale		
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i ndihmës ekonomike	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Punonjës Social	Pika 10	50,000
	Nëpunës të zyrës së informacionit	Pika 11	50,000
	Sanitar në arsim	Pika 11	50,000
	Sanitare e Gjimnazit/9-vjeçare	Pika 11	50,000
	Kaldaist	Pika 11	50,000
	Bibliotekar	Pika 11	50,000
7	Sektori Juridik /Burimet Njerëzore/TIK/Arkiv protokoll		
	Specialist jurist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i burimeve njerëzore	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist IT	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist/koordinator për të drejtën e informimit dhe ankesave	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000

	Specialist arkiv-protokoll	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
8	Njësia Administrative Zagorie		
	Administrator	L-8/P-4	143,500
	Mirëmbajtës i ndriçim, rrugë të brendshme	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
9	Njësia Administrative Qendër Libohovë		
	Administrator	L-8/P-4	143,500
	Mirëmbajtës i ndriçim, rrugë të brendshme	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i parqe lulishte, dekor, pastrim rrugësh, mbetje urbane	Pika 10	50,000
10	Sekretar Këshilli		
	Sekretar këshilli	II-2	144,525
11	Projektit "Shërbim lëvizës për moshën e tretë dhe personave me aftësi të kufizuar - Një vatër e ngrohtë përtej sfidave të moshës dhe pamundësisë"		
	Infermier	Pika 10	50,000
	Punonjës social	Pika 10	50,000
	Kujdestar	Pika 10	50,000
	Shofer	Pika 11	50,000
12	Pergjegjes I gjendjes civile	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000

Nr	Emërtimi sipas strukturës	Grupi/klasa	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për kualifikim e vështirësi	Shtesa për pozicion
1	Edukatore në kopsht Fëmijësh	Grupi 1,2,3 ose 4	14.000	0.6% e pozicionit (1-10 vite) 0.8% (11-20 vite) 1% (21-30 vite)	10% 20%, 30%	61,000
2	Sanitare gjimnazit	Pika 11		1%	1725	50,000

Nr	Niveli	Grada	Paga baze per grade	Shtesa per vjetërsi	Shtesa për per natyre te vecante pune
1	Niveli baze	Asistent zjarrfikës	65,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	7.000
		Zjarrfikës	69,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	8.000
		Komisar Zjarrfikës	88,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000
		Kryezjarrfikës	73,500	1% te gradë të asistent zjarrfikës	8,000
2	Niveli i mesem	Nënkomisar Zjarrfikës	78,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës 1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000
		Kryekomisar Zjarrfikës	108,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000

Nr	Grupi i diplomës	Vlera
1	Master i shkencave ,Master i arteve të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14.000 lekë
2	Master profesional , të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12.000 lekë
3	Bachelor ,Master i arteve të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10.000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1618 Prot

Libohovë më 14.07.2026

PROJEKT-VENDIM
NR _____, DATË 20.07.2026

**MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR NËNPUNËSIT CIVIL DHE PUNONJËSIT
E BASHKISË PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore Kreu IX, pika 1 të nenit 55, nenit 54 pika ç dhe dh, pika 2 e nenit 55, të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 „Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve , të ligjit nr.152/2013 „Për nënpunësit Civil „ të ndryshuar ,të VKM nr.108 datë 26.02.2014“për planin Vjetor të pranimi në shërbimin Civil, Në mbështetje të VKM nr.113 ,datë 01.03.2023 për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi , të vendimin nr.502 , datë 01.08.2024 të ndryshuar me vendimin nr .103 ,datë 11.02.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (sipas lidhjet nr 6), të Vendimin nr.548, datë 27.07.2016 për miratimin e kriterëve rregullave dhe procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejne funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit, të VKM nr .127 datë 27.02.2026,“Për disa ndryshime në vendimin nr.425 datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave „Për trajtimin me pagë dhe shtesa ,mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar të ndryshuar , , të Vendimin nr.104, datë 11.02.2026 , Për një ndryshim në Vendimin nr.419 ,date 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave , “ Për trajtim me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit” ,Këshilli me propozim te kryetarit te Bashkisë :

VENDOSI:

I. Të miratojë nivelit e pagave për nëpunësit civilë dhe punonjësit e bashkisë për vitin 2026”, Për Bashki me numër banorësh nga 5.000 deri në 20.000 (lidhja nr.6) si më poshtë:

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefekti i Qarkut.

JURIST
KRISTAQ CIKO

SHEF.SEK.FINANCIAR
JOANA MEMO



	POZICIONI	Kategoria	Shtesa per pozicion
1	Kryetari i BASHKISË	1/ç	246,000
1.1	Kabineti i kryetarit		
	Nënkryetar	1/ç	189,625
	Këshilltar i kryetarit	III-2	109,000
1.2	Spektori për koordinimin e integritimit European dhe Ndhmës së Huaj		
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
1.3	Spektori Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit		
	Inspektor i mbrojtjes së territorit	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Inspektor i policisë bashkiake	Pika 10	50,000
2	Spektori i zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar		
	Shef Spektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Magaznier	Pika 11	50,000
3	Spektori i Tatim - Taksave		
	Shef sektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000
	Nëpunës i vjeljes së taksave	Pika 11	50,000
4	Spektori i shërbimeve bujqësore veterinarë mjedisore		
	Specialist i bujqësisë	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i pyje kullota menaxhim	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i pyje kullota inspektim	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Mirëmbajtës pyje kullota (kontroll)	Pika 10	50,000
5	Spektori i shërbimit urban		
	Shef Spektori	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000



	Specialist topograf	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist Inxhinier ndërtimi/mjedis trajtim ujërash	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
5.1	Spektori i shërbimeve publike		
	Mbikqyrës i shërbimeve publike	Pika10	50,000
	Muratorë	Pika 10	50,000
	Muratorë i rrugëve rurale	Pika10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i parqe lulishte ,dekor,pastrim rrugësh,mbetje urbane	Pika10	50,000
	Shofer makinerish	Pika 10	50,000
	Elektriçist	Pika 10	50,000
	Shofer administrate	Pika 11	50,000
	Mirëmbajtës godine (zyra)	Pika10	50,000
6	Spektori i kulturës , arsimit dhe mirëqënies sociale		
	Specialist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i ndihmës ekonomike	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Punonjës Social	Pika 10	50,000
	Nëpunës të zyrës së informacionit	Pika 11	50,000
	Sanitar në arsim	Pika 11	50,000
	Sanitare e Gjinnnazit/9-vjeçare	Pika 11	50,000
	Kaldaist	Pika 11	50,000
	Bibliotekar	Pika 11	50,000
7	Spektori Juridik /Burimet Njerëzore/TIK/Arkiv protokoll		
	Specialist jurist	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist i burimeve njerëzore	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist IT	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
	Specialist/koordinator për të drejtën e informimit dhe ankesave	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000



	Specialist arkiv-protokoll	IV-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	75,000
8	Njësia Administrative Zagorie		
	Administrator	L-8/P-4	143,500
	Mirëmbajtës i ndriçim, rrugë të brendshme	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
9	Njësia Administrative Qendër Libohovë		
	Administrator	L-8/P-4	143,500
	Mirëmbajtës i ndriçim, rrugë të brendshme	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i rrugëve rurale	Pika 10	50,000
	Mirëmbajtës i parqe lulishte, dekor, pastrim rrugësh, mbetje urbane	Pika 10	50,000
10	Sekretar Këshilli		
	Sekretar këshilli	II-2	144,525
11	Projektit "Shërbim lëvizës për moshën e tretë dhe personave me aftësi të kufizuar - Një vatër e ngrohtë përtej sfidave të moshës dhe pamundësisë"		
	Infermier	Pika 10	50,000
	Punonjës social	Pika 10	50,000
	Kujdestar	Pika 10	50,000
	Shofer	Pika 11	50,000
12	Pergjegjes I gjendjes civile	III-3 Vjetersi 0.6%, 0.8% 1% e funksionit	102,000

Nr	Emërtimi sipas strukturës	Grupi/klasa	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për kualifikim e vështirësi	Shtesa për pozicion
1	Edukatore në kopsht Fëmijësh	Grupi 1,2,3 ose 4	14.000	0.6% e pozicionit (1-10 vite) 0.8% (11-20 vite) 1% (21-30 vite)	10% 20%, 30%	61,000
2	Sanitare gjimnazit	Pika 11		1%	1725	50,000

Nr	Niveli	Grada	Paga baze per grade	Shtesa per vjetërsi	Shtesa për per natyre te vecante pune
1	Niveli baze	Asistent zjarrfikës	65,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	7.000
		Zjarrfikës	69,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	8.000
		Komisar Zjarrfikës	88,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000
		Kryezjarrfikës	73,500	1% te gradë të asistent zjarrfikës	8,000
2	Niveli i mesem	Nënkomisar Zjarrfikës	78,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës 1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000
		Kryekomisar Zjarrfikës	108,000	1% te gradë të asistent zjarrfikës	6.000

Nr	Grupi i diplomës	Vlera
1	Master i shkencave ,Master i arteve të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14.000 lekë
2	Master profesional , të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12.000 lekë
3	Bachelor ,Master i arteve të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10.000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1518 Prot

Libohovë më 14.07.2026

RELACION

Në mbështetje të VKM-ve Të sipercituara Civil, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me vendimet e saj përkatëse të Këshillit të Ministrave, ka miratuar rritjen e nivelit të pagave për kategori të caktuara punonjësish, duke përcaktuar detyrimisht nivelet e reja të pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), si dhe për edukatorët, të cilat zbatohen sipas akteve normative në fuqi.

Për këto kategori, Bashkia Libohovë është e detyruar të zbatojë nivelet e pagave të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, për pjesën tjetër të administratës së bashkisë, ku legjislacioni u njeh njësive të vetëqeverisjes vendore të drejtën e përcaktimit të nivelit të pagës brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të miratuar me aktet nënligjore, propozohet rritja e pagave në kufirin maksimal të lejuar.

Ky propozim mbështetet në disa arsye objektive:

1. Rritjen e motivimit dhe të performancës së punonjësve të administratës;
2. Përmirësimin e kushteve të punësimit dhe rritjen e stabilitetit të burimeve njerëzore;
3. Vështirësitë e vazhdueshme që Bashkia Libohovë ka hasur ndër vite në rekrutimin dhe mbajtjen e punonjësve të kualifikuar;
4. Rritjen e konkurrueshmërisë së administratës vendore në raport me institucionet e tjera publike;
5. Nevojën për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Praktika e viteve të kaluara ka treguar se nivelet aktuale të pagave kanë ndikuar negativisht në interesin e kandidatëve për vendet e lira të punës, duke sjellë në disa raste mungesë aplikimesh ose vështirësi në plotësimin e strukturës organizative të bashkisë. Për këtë arsye, rritja e pagave,

në kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni, konsiderohet një masë e domosdoshme për të përmirësuar kapacitetet institucionale dhe për të garantuar administrim më efikas

Kërkojmë nga ana juaj të miratohen këto nivele pagash. Sipas tabelave bashkëlidhur.
Me konsideratën më të lartë!

Shef. Sektorit Financiar
Joana Memo

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Joana Memo', with a date '2026' written below it.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1546 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 39 Datë 20.07.2026

PËR

**ZBATIMIN E PROJEKTIT ME TITULL "FIRESMARTER" NË KUADËR TË
INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, INTERREG IV-A, IPA III, PROGRAMI I
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027 DHE
PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË PROGRAMIN BUXHETOR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28,

pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull "FIRESMARTER", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, Marrëveshjes së famosur midis palëve përfaqësuese dhe propozimit të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Libohovë,


VENDOSI:

1. Të miratojë zbatimin e projektit me titull "Firesmarter", në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financuar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi – Shqipëri, 2021-2027.

2. Të pranojë financimin e akorduar për Bashkinë Libohovë në kuadër të projektit "Firesmarter", në shumën prej 189.500 EUR, sipas marrëveshjes së grantit/partneritetit dhe dokumentacionit përkatës të projektit.
3. Të miratojë përfshirjen e fondeve të projektit në buxhetin vendor të Bashkisë Libohovë, si të ardhura dhe shpenzime të kushtëzuara për zbatimin e projektit, në përputhje me rregullat e përcaktuara të marrëveshjes kuadër për projektet me financim të huaj dhe të aplikoj rregullat e PRAG.
4. Bashkia Libohovë, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.
5. Të autorizojë vijimin e zbatimit të projektit nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Libohovë, në përputhje me marrëveshjen e grantit/partneritetit, planin e aktiviteteve, buxhetin e projektit dhe rregullat e menaxhimit financiar publik.
6. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës/Buxhetit dhe strukturat përkatëse të Bashkisë për regjistrimin e fondeve në buxhet, ndjekjen e shpenzimeve, raportimin financiar dhe ruajtjen e dokumentacionit justifikues për të gjitha veprimet e kryera në kuadër të projektit.
7. Të ngarkojë njësinë/strukturën përgjegjëse për projektin që të raportojë periodikisht pranë Kryetarit të Bashkisë dhe, sipas rastit, pranë Këshillit Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të projektit, realizimin e aktiviteteve dhe përdorimin e fondeve.
8. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Libohovë, të ndjekë të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



Miraturar me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



FIRESMARTER

REPUBLIKA SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KRYETARI

Nr. 1448 Prot

Libohovë më 09.04 2026

PROJEKT - VENDIM

PËR

ZBATIMIN E PROJEKTIT ME TITULL "FIRESMARTER" NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, INTERREG IV-A, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027 DHE PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË PROGRAMIN BUXHETOR

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull "FIRESMARTER", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, Marrëveshjes së firmosur midis palëve përfaqësuese dhe relacionit shpjegues nr. datë 2026

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë zbatimin e projektit me titull "Firesmarter", në kuadër të instrumentit të para antarësimit, IPA III, financiar nga Programi i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi – Shqipëri, 2021-2027.
2. Të pranojë financimin e akorduar për Bashkinë Libohovë në kuadër të projektit "Firesmarter", në shumën prej 189.500 EUR, sipas marrëveshjes së grantit/partneritetit dhe dokumentacionit përkatës të projektit.
3. Të miratojë përfshirjen e fondeve të projektit në buxhetin vendor të Bashkisë Libohovë, si të ardhura dhe shpenzime të kushtëzuara për zbatimin e projektit, në përputhje me rregullat e përcaktuara të marrëveshjes kuadër për projektet me financim të huaj dhe të aplikoj rregullat e PRAG.
4. Bashkia Libohovë, si partner në këtë projekt, bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projekte IPA, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe

TVSH-së bazuar në buxhetin e palës shqiptare dhe përfshirjen e kësaj kostoje dhe TVSH-së në buxhet.

5. Të autorizojë vijimin e zbatimit të projektit nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Libohovë, në përputhje me marrëveshjen e grantit/partneritetit, planin e aktiviteteve, buxhetin e projektit dhe rregullat e menaxhimit financiar publik.

6. Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

Specialist/Sektori I Integritit

Esmeralda Lile



Jurist

Kristaq Ciko





FIRESMARTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E LIBOHOVË
SEKTORI I INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 1448/1 Prot

Libohovë më 09.04.2026

RELACION

PËR

ZBATIMIN E PROJEKTIT ME TITULL "FIRESMARTER" NË KUADËR TË
INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, INTERREG IV-A, IPA III, PROGRAMI I
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027 DHE
PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË PROGRAMIN BUXHETOR

Ky relacion paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak Libohovë, për pjesëmarrjen e Bashkisë Libohovë si përfitues dhe zbatues (Project Beneficiary 4 – PB4) në projektin "FIRESMARTER" Promovimi i Zonave të Zgjuara ndaj Zjarrit (FST), i cili financohet në kuadër të Programit Interreg VI -A IPA Greqi – Shqipëri 2021 – 2027.

BAZA LIGJORE:

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull "FIRESMARTER", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027, Marrëveshjes së firmosur midis palëve përfaqësuese në partneritet.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT:

Projekti FIRESMARTER adreson rrezikun në rritje të zjarreve në pyje në rajonin ndërkufitar Greqi – Shqipëri, një zonë e prekur gjithnjë e më shumë nga ndryshimet klimatike, braktisja e tokave dhe grumbullimi i biomasës, të cilat rrisin ndjeshmërinë e pyjeve ndaj zjarreve.

Qëllimi i projektit është:

- Të promovojë konceptin inovativ të Zonave të Zgjuara ndaj Zjarrit (Fire - Smart Territories – FST) duke kombinuar përdorimin e qëndrueshëm të tokës, menaxhimin e karburantit natyror dhe teknologji inteligjente për zbulimin e hershëm të zjarreve.

Të hartojë Plane të Përbashkëta të Menaxhimit të Pyjeve (FMPs) në 7 zona me rrezik të lartë, me synimin për të reduktuar ekspozimin ndaj zjarreve dhe për të rritur qëndrueshmërinë e pyjeve.

- Të vendosë një sistem të integruar survejimi, përmes UAV-ve dhe kamerave inteligjente, për monitorim në kohë reale dhe paralajmërim të hershëm.
- Të zhvillojë një Sistem të Kredive të Karbonit të Pyjeve (FCCS) për të nxitur pyllëzimin e qëndrueshëm dhe sekuestrimin e karbonit.
- Të mbështesë klasterët e bioekonomisë, duke nxitur sipërmarrjen e gjelbër në zonat e largëta dhe të rrezikuara nga zjarret.

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- Politika më të forta për përshtatje ndaj klimës,
- Parandalim më të mirë të zjarreve,
- Rigjallërim i ekonomive rurale dhe
- Modele të shkallëzueshme për aplikim më të gjerë në BE.

DETYRIMET E BASHKISË LIBOHOVË DHE BUXHETI I MIRATUAR

Në këtë projekt, Bashkia Libohovë do të marrë pjesë si Partner Përfitues (PB4). Për zbatimin e aktiviteteve të saj brenda projektit, parashikohet buxheti i mëposhtëm (pa TVSH):

Kategoria e Buxhetit	Shuma (€)
Kostot e stafit	16,500.00
Zyra & Administrim	2,475.00
Udhëtime & Akomodim	8,800.00
Ekspertizë & Shërbime të Jashtme	71,725.00
Pajisje	90,000.00
Infrastrukturë & Punime	0.00
Totali	189,500.00

NË PËRFUNDIM

Duke konsideruar rëndësinë strategjike të këtij projekti për rritjen e kapaciteteve të Bashkisë Libohovë në menaxhimin dhe parandalimin e zjarreve në pyje, përmirësimin e infrastrukturës së monitorimit dhe angazhimin në zhvillime të qëndrueshme mjedisore dhe ekonomike, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak Libohovë i pjesëmarrjes së Bashkisë në projektin FIRESMARTER dhe i buxhetit të mësipërm. Bashkangjitur marrëveshja e partneritetit përmbledhje e projektit.

Konceptoi: E. Lile

Miratoi: K. Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. 157 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 40 Datë 20.07.2026

PËR

**MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË LIBOHOVË NË PROJEKTIN
CLEAR-AL", FINANCUAR NGA PROGRAMI HORIZON EUROPE - KONSORCIUMI
CLIMAAAX, PRANIMIN E FINANCIMIT DHE PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË
BUXHETIN VENDOR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28,

pika 1, nenit 54, shkronja "l", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 47/2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin", si dhe bazuar në marrëveshjen e nëngrantit/partneritetit të projektit "Clear-al", financuar nga Programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian dhe zbatuar nga konsorciumi CLIMAAAX, datë 20.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOS:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Libohovë në projektin "CLEAR-AL", (Qasja e Rezistencës ndaj Klimës dhe Menaxhimit të rrezikut ndaj përmbytjeve dhe erozionit përmes përgjigjes dhe përshtatjes së bazuar në të dhëna në Libohovë), në cilësinë e partnerit/zbatuesit të projektit.

2. Të pranojë financimin (nëngrandin) e akorduar për Bashkinë Libohovë në kuadër të projektit "CLEAR-AL", në shumën prej 130.000 EUR, sipas marrëveshjes së grantit/partneritetit dhe dokumentacionit përkatës të projektit, duke përdorur metodologjinë CLIMAAX (Climate risk and vulnerability Assessment framework and toolbox/Kuadri metodologjik dhe paketa e mjeteve për vlerësimin e rrezikut dhe cTë miratojë përfshirjen e fondeve të projektit në buxhetin vendor të Bashkisë Libohovë, si të ardhura dhe shpenzime të kushtëzuara për zbatimin e projektit, në përputhje me rregullat e Programit Horizon Europe, marrëveshjen e nëngrantit/partneritetit dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. Të marrë dijeni për veprimet administrative dhe financiare të kryera deri në datën e miratimit të këtij vendimi në kuadër të zbatimit të projektit, përfshirë ngritjen e grupit të punës me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe shpenzimet e kryera për nevoja të projektit, sipas dokumentacionit justifikues dhe rregullave të financuesit.

4. Të autorizojë vijimin e zbatimit të projektit nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Libohovë, në përputhje me marrëveshjen e grantit/partneritetit, planin e aktiviteteve, buxhetin e projektit dhe rregullat e menaxhimit financiar publik.

5. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës/Buxhetit dhe strukturat përkatëse të Bashkisë për regjistrimin e fondeve në buxhet, ndjekjen e shpenzimeve, raportimin financiar dhe ruajtjen e dokumentacionit justifikues për të gjitha veprimet e kryera në kuadër të projektit.

6. Të ngarkojë njësinë/strukturën përgjegjëse për projektin që të raportojë periodikisht pranë Kryetarit të Bashkisë dhe, sipas rastit, pranë Këshillit Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të projektit, realizimin e aktiviteteve dhe përdorimin e fondeve.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Shënderi

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratur me 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KRYETARI**

Nr. 1444 Prot

Libohovë më 09.04 2026

PROJEKT - VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË LIBOHOVË NË PROJEKTIN
CLEAR-AL", FINANCUAR NGA PROGRAMI HORIZON EUROPE - KONSORCIUMI
CLIMAAX, PRANIMIN E FINANCIMIT DHE PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË
BUXHETIN VENDOR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 47/2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin", si dhe bazuar në marrëveshjen e nëngrantit/partneritetit të projektit "Clear-al", financuar nga Programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian dhe zbatuar nga konsorciumi CLIMAAX,

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Libohovë në projektin "CLEAR-AL", (Qasja e Rezistencës ndaj Klimës dhe Menaxhimit të rrezikut ndaj përmbytjeve dhe erozionit përmes përgjigjes dhe përshtatjes së bazuar në të dhëna në Libohovë), në cilësinë e partnerit/zbatuesit të projektit.
2. Të pranojë financimin (nëngrandin) e akorduar për Bashkinë Libohovë në kuadër të projektit "CLEAR-AL", në shumën prej 130.000 EUR, sipas marrëveshjes së grantit/partneritetit dhe dokumentacionit përkatës të projektit, duke përdorur metodologjinë CLIMAAX (Climate risk and vulnerability Assessment framework and toolbox/Kuadri metodologjik dhe paketa e mjeteve për vlerësimin e rrezikut dhe cenueshmërisë klimatike).
3. Të miratojë përfshirjen e fondeve të projektit në buxhetin vendor të Bashkisë Libohovë, si të ardhura dhe shpenzime të kushtëzuara për zbatimin e projektit, në përputhje me rregullat

e Programit Horizon Europe, marrëveshjen e nëngrantit/partneritetit dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

4. Të marrë dijeni për veprimet administrative dhe financiare të kryera deri në datën miratimit të këtij vendimi në kuadër të zbatimit të projektit, përfshirë ngritjen e grupit të punës me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe shpenzimet e kryera për nevoja të projektit, sipas dokumentacionit justifikues dhe rregullave të financuesit.
5. Të autorizojë vijimin e zbatimit të projektit nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Libohove, në përputhje me marrëveshjen e grantit/partneritetit, planin e aktiviteteve, buxhetin e projektit dhe rregullat e menaxhimit financiar publik.
6. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës/Buxhetit dhe strukturat përkatëse të Bashkisë për regjistrimin e fondeve në buxhet, ndjekjen e shpenzimeve, raportimin financiar dhe ruajtjen e dokumentacionit justifikues për të gjitha veprimet e kryera në kuadër të projektit.
7. Të ngarkojë njësinë/strukturën përgjegjëse për projektin që të raportojë periodikisht pranë Kryetarit të Bashkisë dhe, sipas rastit, pranë Këshillit Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të projektit, realizimin e aktiviteteve dhe përdorimin e fondeve.
8. Bashkëlidhur relacioni shpejgues.

Specialist/Sektori I Integritetit

Esmeralda Lile



Jurist

Kristaq Ciko





CLIMAAX

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI INTEGRIMIT EVROPIAN DHE NDIHMËS SË HUAJ**

Nr. 1444 / Prot

Libohovë më 09.07 2026

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË LIBOHOVË NË PROJEKTIN
CLEAR-AL", FINANCUAR NGA PROGRAMI HORIZON EUROPE - KONSORCIUMI
CLIMAAX, PRANIMIN E FINANCIMIT DHE PËRFSHIRJEN E FONDEVE NË
BUXHETIN VENDOR**

Ky relacion ka për qëllim informimin e Këshillit Bashkiak Libohovë mbi pjesëmarrjen e Bashkisë në projektin evropian CLEAR-AL (Qasja e Rezistencës ndaj Klimës dhe Menaxhimit të Rrezikut ndaj Përmbytjeve dhe Erozionit përmes Përgjigjes së Përshtatjes së Bazuar në Të Dhëna në Libohovë) (Climate risk and vulnerability Assessment framework and toolbox/ Kuadri metodologjik dhe paketa e mjeteve për vlerësimin e rrezikut dhe cënueshmërisë klimatike), i cili financohet nga Programi Horizon Europe dhe ka për synim forcimin e kapaciteteve të rajoneve për të kryer vlerësime të rrezikut klimatik dhe hartimin e planeve për menaxhimin e emergjencave klimatike dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

BAZA LIGJORE:

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 47/2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian Horizont Evropa – programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin", si dhe bazuar në marrëveshjen e nëngrantit/partneritetit të projektit "Clear-al", financuar nga Programi Horizon Europe i Bashkimit Evropian dhe zbatuar nga konsorciumi CLIMAAX.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT:

Projekti CLEAR-AL mbështet krijimin e një kuadri të standardizuar për vlerësimin e rreziqeve klimatike (CRA) dhe pajisjen e rajoneve me një sistem që përfshin të dhëna, modele dhe mjete për të qasur arkivat europiane dhe globale të të dhënave, të integruara me të dhënat lokale. Ky projekt ofron gjithashtu mbështetje financiare, analitike dhe praktike për përmirësimin e planeve të menaxhimit të klimës dhe emergjencave.

OBJEKTIVAT KRYESORE:

- Ndërtimin e një kuadri të unifikuar për CRA të përshtatshëm për çdo rajon
- Zhvillimin e një seti mjetesh (Toolbox) për përpunim dhe përdorim të të dhënave klimatike
- Përfshirjen e më shumë se 50 rajoneve në BE për të zhvilluar vlerësimet e tyre të rrezikut klimatik.
- Ofrimin e mbështetjes financiare dhe teknike për zbatimin e këtyre vlerësimeve.

ROLI I BASHKISË LIBOHOVË NË PROJEKT:

Bashkia Libohovë është përzgjedhur si një nga përfituesit e mbështetjes financiare për realizimin e një vlerësimi të detajuar të rrezikut nga përmytjet dhe erozioni, përmes përdorimit të të dhënave lokale dhe angazhimit të aktorëve vendorë.

Projekti shtrihet në periudhën 2025 – 2027 dhe përfshin:

- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave lokale;
- Hartimin e strategjive të adaptimit;
- Zhvillimin e zgjidhjeve pilot;
- Pjesëmarrjen në punëtori ndërkombëtare (Barcelona 2025 dhe Bruksel 2026).

Dorëzimet kryesore (deliverables):

- Vlerësimi shumë-rrezik për Libohovën deri në gusht 2025;
- Vlerësimi rajonal i përmirësuar me të dhëna vendore deri në qershor 2026;
- Hartimi i strategjive vendore të adaptimit dhe planeve të menaxhimit të rrezikut deri në dhjetor 2026.

Tabela e Buxhetit të Miratuar për Bashkinë Libohovë:

Zëri	Vlera (€)
Personel	61,600 €
Udhëtime	3,100 €
Mallra ose shërbime të tjera	23,300 €
Shpenzime të drejtpërdrejta (1 + 2)	88,000 €
Shpenzime indirekte (25% e shpenzimeve të drejtpërdrejta)	22,000 €
Nënkontraktime	20,000 €
Totali	130,000 €

PËRFUNDIM:

Ky informacion paraqitet për dijeni dhe mbështetje të mëtejshme nga Këshilli Bashkiak i Libohovës, për të garantuar një zbatim të suksesshëm të projektit CLEAR-AL në territorin e bashkisë sonë. **Bashkëlidhur kontrata dhe anekset përkatëse.**

Konceptoi:E.Lile
Miratoi:K.Ciko



ANEKS SQARUES – REFERUAR KONTRATËS SË GRANTIT



Plani Individual i Percjelljes per Climaax FSTP

Objektivi Kryesor

Objektivi kryesor i projektit CLEAR-AL është të reduktojë cenueshmërinë e Bashkisë Libohovë ndaj ndryshimeve klimatike duke përmirësuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet e përmblyjeve dhe erozionit përmes vlerësimeve të detajuara dhe mbështetjes së politikave e strategjive lokale. Projekti synon ta bëjë komunitetin më rezistent dhe më të përgatitur për sfidat klimatike të së ardhmes.

Objektivat Specifike

Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të rrezikut klimatik duke identifikuar dhe analizuar rreziqet kryesore të lidhura me klimën, si përmblytjet dhe erozioni, që prekin Libohovën, duke përdorur të dhëna evropiane dhe lokale.

- Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit lokal mbi rreziqet klimatike përmes proceseve pjesëmarrëse, duke siguruar që banorët dhe vendimmarrësit të kuptojnë ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike në infrastrukturë dhe bujqësi.
- Mbështetja e zhvillimit të politikave lokale përmes rekomandimeve të bazuara në evidenca për strategjitë e përshtatjes dhe planet e menaxhimit të rrezikut.
- Përmirësimi i rezistencës së infrastrukturës dhe tokave bujqësore të Libohovës përmes projektimit dhe pilotimit të masave të përshtatura të adaptimit, si masat kundër përmblyjeve dhe kontrollit të erozionit.

Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI)

Faza 1 – Vlerësimi Klimatik me Shumë Rreziqe

- Produkti D1: Zbatimi i metodologjisë së përbashkët CLIMAAX dhe analizimi i rezultateve.
- 2 procese pune të zbatuara me sukses.
- 10 palë të interesuara të përfshira.
- 4 aktivitete komunikimi dhe informimi.
- 1 raport i detajuar i profilit të rrezikut deri në muajin e 6-të.

Faza 2 – Vlerësim i Detajuar Rajonal/Lokal

- Produkti D2: Analizë e avancuar lokale dhe krahasim i rezultateve.
- 8 grupe të dhënash të integruara.
- 3 konsultime me ekspertë të jashtëm.
- 5 harta GIS për zonat me rrezik përmblyjeje dhe erozioni.
- 2 dokumente rekomandimesh për politikëbërësit.

- 1 raport plotë i vlerësimit të rrezikut deri në muajin e 16-të.

Faza 3 – Strategjitë e Adaptimit Klimatik

- Produkti D3: Kontribut në strategjitë lokale të adaptimit dhe planet e menaxhimit të rrezikut.
 - 3 masa adaptimi të identifikuar dhe prioritizuara.
 - 1 masë pilot e zbatuar.
 - 2 plane të përditësuara të menaxhimit të rrezikut.
 - 3 artikuj në mediat rajonale.
 - 5 aktivitete shpërndarjeje të rezultateve.
 - KPI të Përgjithshme të Projektit
 - 15 palë të interesuara të angazhuara.
 - 8 aktivitete komunikimi dhe ndërgjegjësimi.
 - 2 dokumente politike (policy briefs).
 - 1 raport përfundimtar projekti.
 - 1 anketim kënaqësie me rezultat minimal 80%.

Ndikimi

3.1 Rezultatet dhe Ndikimet e Pritshme

Vlerësim gjithëpërfshirës i rrezikut klimatik

- Do të realizohet një analizë e detajuar dhe e bazuar në të dhëna për rreziqe si përmytjet dhe erozioni, duke krijuar një kuptim të qartë të cenueshmërisë së rajonit.
- Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit lokal
- Projekti do të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit mbi shkaqet dhe pasojat e përmytjeve dhe erozionit, duke fuqizuar qytetarët dhe autoritetet lokale të ndërmarrin masa parandaluese.
- Strategji të përshtatura të adaptimit
- Do të hartohen strategji të bazuara në evidenca për reduktimin e përmytjeve dhe kontrollin e erozionit, të përshtatura sipas karakteristikave gjeografike dhe socio-ekonomike të Libohovës.
- Përmirësimi i politikave dhe planeve lokale
- Projekti do të ndihmojë në përditësimin e politikave dhe planeve të menaxhimit të rrezikut, duke orientuar investimet e ardhshme në infrastrukturë dhe menaxhimin e territorit.
- Forcimi i angazhimit të komunitetit
- Përfshirja e fermerëve, liderëve lokalë dhe ekspertëve teknikë do të sigurojë që zgjidhjet e propozuara të jenë praktike dhe të mbështetura nga komuniteti.
- Rritja e rezistencës afatgjatë
- Do të forcohet kapaciteti i bashkisë për të menaxhuar rreziqet klimatike dhe për të zbatuar zgjidhje të qëndrueshme afatgjata.
- Zbatimi pilot i masave të adaptimit
- Do të realizohen ndërhyrje pilot në shkallë të vogël për të testuar efektivitetin e masave të propozuara dhe për të nxjerrë mësim për zbatime më të gjera në të ardhmen.

3.2 Palët Kryesore të Interesuara dhe Përfituesit

Palët Kryesore të Interesuara

- Bashkia Libohovë
- Ekspertë teknikë në menaxhimin e rrezikut klimatik dhe zhvillimin e infrastrukturës
- Grupe mjedisore
- Organizata të shoqërisë civile
- Përfituesit Kryesorë
- Banorët lokalë, veçanërisht ata që jetojnë në zona të rrezikuara nga përmytjet
- Fermerët, tokat e të cilëve rrezikohen nga erozioni
- Bizneset lokale
- Pronarët e pronave
- Komuniteti në tërësi
- Ndërveprimi me Palët e Interesuara
- Projekti do të angazhojë palët e interesuara përmes konsultimeve të rregullta, seminareve, takimeve dhe sesioneve të marrjes së mendimeve. Përfituesit do të përfshihen nëpërmjet takimeve komunitare dhe fushatave ndërgjegjëse për të rritur kuptimin mbi rreziqet klimatike dhe për të promovuar mbështetjen ndaj zgjidhjeve të propozuara.

3.3 Masat për Maksimizimin e Ndikimit

1. Vlerësim gjithëpërfshirës i rrezikut klimatik

Masat:

- Kryerja e një vlerësimi të detajuar me shumë rreziqe duke përdorur të dhëna evropiane dhe lokale.
- Zbatimi i metodologjisë CLIMAAX për identifikimin e rreziqeve kryesore.
- Përdorimi i teknologjisë GIS dhe të dhënave topografike me rezolucion të lartë.
- Veprimi lokal: Përfshirja e autoriteteve lokale dhe ekspertëve teknikë gjatë mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

2. Angazhimi i palëve të interesuara dhe fushatat ndërgjegjëse

Masat:

- Organizimi i seminareve, takimeve dhe sesioneve konsultuese.
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse për rreziqet klimatike.
- Veprimi lokal: Emërimi i përfaqësuesve të komunitetit si urë lidhëse ndërmjet ekipit të projektit dhe grupeve lokale.

3. Strategji të përshtatura të adaptimit

Masat:

- Projektimi dhe zbatimi i masave specifike sipas nevojave lokale.
- Propozimi i infrastrukturës për mbrojtje nga përmytjet.
- Zhvillimi i masave për kontrollin e erozionit.
- Prioritizimi i zgjidhjeve me kosto efektive.
- Veprimi lokal: Bashkëpunimi me inxhinierë lokalë, OJF mjedisore dhe fermerë për testimin e masave pilot.

4. Integrimi në politika dhe ngritja e kapaciteteve

Masat:

- Integrimi i gjetjeve të projektit në planet dhe politikat lokale.
- Organizimi i trajnimeve për stafin bashkiak dhe aktorët lokalë.
- Veprimi lokal: Krijimi i një grupi pune të posaçëm brenda bashkisë për monitorimin e zbatimit të politikave të reja.

5. Fuqizimi i komunitetit

Masat:

- Nxitja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje.
- Promovimi i historive të suksesit dhe praktikave të mira.
- Veprimi lokal: Krijimi i një "Komiteti të Rezistencës Klimatike" me liderë lokalë, fermerë dhe të rinj.

6. Monitorimi dhe vlerësimi

Masat:

- Krijimi i një sistemi monitorimi për matjen e efektivitetit të masave.
- Përdorimi i treguesve KPI.
- Rishikime periodike dhe përmirësime sipas nevojës.
- Veprimi lokal: Trajnimi i vullnetarëve lokalë për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin.

7. Shkëmbimi i njohurive dhe shpërndarja e rezultateve

Masat:

- Publikimi i raporteve, dokumenteve politike dhe studimeve të rasteve.
- Organizimi i seminareve dhe webinareve rajonale.
- Veprimi lokal: Krijimi i një platforme online ose tabele informimi për komunitetin.

8. Qëndrueshmëria afatgjatë

Masat:

- Sigurimi i vazhdimësisë së rezultateve edhe pas përfundimit të projektit.
- Kërkimi i financimeve dhe partneriteteve shtesë.
- Integrimi i rezistencës klimatike në planifikimin e ardhshëm të bashkisë.
- Veprimi lokal: Nxitja e bizneseve dhe pronarëve për investime në praktika miqësore me klimën.

4. Zbatimi

4.1 Plani i Punës

Faza 1 – Zbatimi i Metodologjisë së Përbashkët CLIMAAX



Objektivi

- Krijimi i profilit bazë të rrezikut me shumë rreziqe për Bashkinë Libohovë.
- Aktivitetet
- Përdorimi i të dhënave evropiane dhe mjeteve CLIMAAX për vlerësimin fillestar.
- Identifikimi i rreziqeve kryesore si përmytjet dhe erozioni.
- Analiza e ndikimit mbi infrastrukturën, bujqësinë dhe zonat urbane.
- Analiza e ngjarjeve ekstreme të motit dhe reshjeve intensive.
- Rezultati
- Hartimi i profilit fillestar të rrezikut të Libohovës që do të shërbejë si bazë për analizat e mëtejshme.

Faza 2 – Përmirësimi i Vlerësimit të Rrezikut

Objektivi

- Përmirësimi i saktësisë së analizës fillestare përmes përdorimit të të dhënave lokale me rezolucion të lartë.

Aktivitetet

- Mbledhja e hartave topografike, të dhënave klimatike historike dhe hidrologjike.
- Përdorimi i GIS për modelimin e zonave të rrezikuara.
- Bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore.
- Integrimi i të dhënave mbi tokën, rrjedhën e ujërave dhe produktivitetin bujqësor.

Rezultati

- Një vlerësim i avancuar dhe më i saktë i cënueshmërisë së Libohovës.

Faza 3 – Hartimi i Masave të Adaptimit

Objektivi

- Zhvillimi i masave praktike të adaptimit bazuar në rezultatet e analizave.
- Aktivitetet
- Angazhimi i kompanive inxhinierike dhe organizatave mjedisore.

Analizimi i alternativave si:

- Barriera kundër përmytjeve,
- Sisteme kullimi,
- Terasime,
- Pyllëzim.
- Konsultimi me fermerët dhe komunitetin.
- Integrimi i rekomandimeve në planet lokale.

Rezultati

Një paketë masash konkrete adaptimi, të mbështetura nga komuniteti dhe të përshtatura me nevojat e Libohovës.

4.2 Grafiku Kohor (Gantt Chart)

Grafiku Gantt paraqet planifikimin kohor të aktiviteteve të projektit përgjatë 22 muajve të zbatimit. Aktivitetet janë të organizuara sipas tre fazave kryesore:

- Faza 1: Mars 2025 – Gusht 2025
- Faza 2: Shtator 2025 – Qershor 2026
- Faza 3: Korrik 2026 – Dhjetor 2026

4.3 Produktet (Deliverables)

Nr. Faza Emri Afati

D1

- Vlerësimi klimatik me shumë rrezeqe
- Zbatimi i metodologjisë CLIMAAX dhe analiza e rezultateve
- Muaji 6 (Gusht 2025)

D2

- Vlerësimi lokal i përmirësuar
- Analizë e avancuar me të dhëna lokale dhe krahasim i rezultateve
- Muaji 16 (Qershor 2026)

D3

- Strategjitë e adaptimit dhe planet e menaxhimit të rrezikut
- Kontribut në strategjitë lokale dhe përmirësimin e planeve të menaxhimit të rrezikut
- Muaji 22 (Dhjetor 2026)

4.4 Piketat Kryesore (Milestones)

Faza 1

- M1 Përfundimi i mbledhjes fillestare të të dhënave dhe angazhimi i palëve të interesuara.
- M2 Zbatimi me sukses i metodologjisë CLIMAAX për vlerësimin me shumë rrezeqe.
- M3 Identifikimi dhe hartëzimi i zonave të cënueshme në Libohovë.
- M4 Dorëzimi i raportit paraprak dhe profilit të rrezikut.
- M5 Pjesëmarrja në workshop-in CLIMAAX në Barcelonë (maj 2025).

Faza 2

- M6 Mbledhja dhe integrimi i të dhënave lokale me rezolucion të lartë.
- M7 Përmirësimi i modeleve të rrezikut dhe validimi nga ekspertë të jashtëm.
- M8 Përfundimi i hartave GIS për zonat me rrezik përmytjeje dhe erozioni.
- M9 Raporti i ndërmjetëm dhe rishikimi i rezultateve.

Faza 3

- M10 Identifikimi i strategjive të përshtatura të adaptimit.

- M11 Konsultimet me aktorët lokalë dhe finalizimi i projekteve teknike.
- M12 Zbatimi i masave pilot.
- M13 Përgatitja e raportit përfundimtar dhe shpërndarja e rezultateve.
- M14 Pjesëmarrja në workshop-in CLIMAAX në Bruksel (Dhjetor 2026).
- M15 Përfundimi i procedurës së nënkontraktimit.



5. Burimet që do të Përdoren

Zëri	Vlera (€)
Personel	61,600 €
Udhëtime	3,100 €
Mallra ose shërbime të tjera	23,300 €
Shpenzime të drejtpërdrejta (1 + 2)	88,000 €
Shpenzime indirekte (25% e shpenzimeve të drejtpërdrejta)	22,000 €
Nënkontraktime	20,000 €
Totali	130,000 €

Shënim:

Kostoja e udhëtimeve duhet të mbulojë pjesëmarrjen e të paktën një përfaqësuesi në:

- Workshop-in CLIMAAX në Barcelonë (2025)
- Workshop-in përfundimtar në Bruksel (2026)

5.2 Arsyetimi i Buxhetit

Projekti CLEAR-AL është hartuar në përputhje të plotë me kriteret e pranueshmërisë së CLIMAAX.

Megjithëse projekti nuk përfshin:

- pajisje,
- sisteme paralajmërimi të hershëm,
- pajisje monitorimi, (ai nuk i konsideron këto kosto si të pranueshme sipas rregullave CLIMAAX),
- Ai përfshin shpenzime të nevojshme për mallra dhe shërbime që janë thelbësore për realizimin e objektivave.
- Shuma prej 23,300 € për mallra dhe shërbime të tjera përfshin:
- licenca software GIS;
- mjete teknike për analizën e rrezikut klimatik;
- materiale për punën në terren;
- materiale të printuara;
- materiale për seminare dhe trajnime.
- Përdorimi i GIS

Softueri GIS do të përdoret për:

- modelimin e zonave të rrezikuara nga përmytjet;
- identifikimin e pikave të erozionit;
- analizën e të dhënave lokale me rezolucion të lartë.

Megjithëse GIS mund të konsiderohet si pajisje teknologjike, në këtë projekt trajtohet si shërbim për shkak të natyrës së abonimit.

Angazhimi i komunitetit

Buxheti përfshin gjithashtu:

- organizimin e seminareve;
- trajnime;
- fushata ndërgjegjëse;
- takime me fermerë, banorë dhe biznese lokale.

Këto aktivitete synojnë të rrisin pjesëmarrjen e komunitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të rezultateve.

5.3 Nënkontraktimi

Ekipi i projektit CLEAR-AL e konsideron nënkontraktimin një element kyç për realizimin me sukses të vlerësimeve klimatike, veçanërisht në Fazat 2 dhe 3 ku kërkohet ekspertizë e specializuar.

Bashkia Libohovë do të zbatojë një procedurë:

- transparente;
- konkurruese;
- në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe udhëzimet CLIMAAX.

Qëllimi është përzgjedhja e ofruesve të shërbimeve me:

- kapacitet teknik të provuar;
- eksperiencë relevante;
- ofertën më të mirë ekonomikisht.

Konceptoi: E. Lile
Miratoi: K. Ciko





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1578 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr.41 Datë 20.07.2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike”, në udhëzimin nr.5, datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”, VKB Libohovë, nr.3 datë 24.01.2025 “Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, Këshillit Bashkiak ,për muajin qershor 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

VENDOSI

I.Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i 6%, për familjet e mëposhtme,për muajin Qershor 2026

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Muaji	Shuma/lek
1	Ferdi Sejfulla Ruli	Qershor 2026	2178

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndiemes Ekonomike.

III.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj

Miratur me 15 (pesëmbëdhjetë) vota

Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota

Vota Kundër : asnjë

Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot

Libohovë ,më 07.07.2026

PROJEKT- VENDIM

Nr 6 datë, 07/07/2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016” Për përcaktimin e kritereve , të procedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike”, në udhëzimin nr.5, datë 17.02.2017.”Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 “ Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” Ligjin 57/2019”Për asistencën sociale në RSH”, VKB Libohovë, nr.3 datë 24.01.2025 “Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë” ,mbështetur në vlerësimin ekonomik –social, Ppropozojmë Këshillit-Bashkiak ,për muajin prill 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Muaji	Shuma/lek
1	Ferdi Sejfulla Ruli	QERSHOR 2026	2178

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihtmes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika



Juristi
Kristaq Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1549 prot

Libohovë më 23.07.2026

VENDIM

Nr. 42 Datë 20.07.2026

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR
FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.**

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016, në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH", VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë, familjet në nevojë që kanë dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, të përfitojnë ndihmë (në lekë) nga fondet e Pushtetit Lokal.

VENDOSI

I. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga Bashkia, për familjet e mëposhtme, për muajin Qershor 2026

	Emër, mbiemër	Arsyet	LEKE
1	Josif Proko	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
2	Marika Mino	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
3	Vilson Buzo	Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur	5000
4	Ferdi Ruli	Person i vetëm, I paaftë për punë	3000
5	Gjergji Ruli	Person i I paaftë për punë	5000
6	Fređi Proko	Person i I paaftë për punë	5000
7	Zenel Çobani	Kryefamiljar në nevojë	5000
8	Enkeleđa Matushi	Prind i vetëm me fëmijë të mitur	5000
9	Madrit Avđuli	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
10	Resul Sinani	Person i I paaftë për punë	5000
11	Shqiponjë Myftaraj	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000


12	Afërdita Mërtiri	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
13	Rigels Ruli	Kryefamiljar në nevojë	5000
14	Niko Karavidha	Person i pazotët për punë	5000
15	Vladimir Zeneli	Kryefamiljar në nevojë	5000
16	Gani Ruçi	Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur	5000
17	Bastri Buzo	Kryefamiljar në nevojë	5000

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.

III.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj




Miratuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vota

Vota Pro : 15 (pesëmbëdhjetë) vota

Vota Kundër : asnjë

Vota Abstenim : asnjë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot.

Libohovë më 07.07.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 06 datë 07/07/2026

PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH", VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kriterëve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, të përfitojnë ndihmë (në lekë) nga fondet e Pushtetit Lokal .

Propozojmë Këshillit Bashkiak.

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga bashkia familjet e mëposhtme,për muajin QERSHOR 2026.

	Emer,mbiemer	Arsyet	LEKE
1	Josif Proko	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
2	Marika Mino	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
3	Vilson Buzo	Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur	5000
4	Ferdi Ruli	Person i vetëm ,I paaftë për punë	3000
5	Gjergji Ruli	Person i I paaftë për punë	5000
6	Fredi Proko	Person i I paaftë për punë	5000
7	Zenel Çobani	Kryefamiljar ne nevojë	5000

8	Enkeleda Matushi	Prind i vetëm me fëmijë të mitur	5000
9	Madrit Avduli	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
10	Resul Sinani	Person i I paafte për punë	5000
11	Shqiponjë Myftaraj	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
12	Afërdita Mërtiri	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
13	Rigels Ruli	Kryefamiljar ne nevojë	5000
14	Niko Karavidha	Person i paafte për punë	5000
15	Vladimir Zeneli	Kryefamiljar ne nevojë	5000
16	Gani Ruçi	Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur	5000

Luten anëtarët e Këshillit Bashkiak të miratojnë ose jo dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin mars 2026.

Spektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika




Juristi
Kristaq Ciko

